



germin

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NË MES TË:

**DREJTORISË SË ARSIMIT, KOMUNA E LIPJANIT
DHE**

ORGANIZATËS GERMIN

Drejtoria e Arsimit, në Komunën e Lipjanit - rruga "Shqipëria" nr.28, 14000, Komuna e Lipjanit i përfaqësuar nga znj. Elmaze Behluli, në tekstin e mëtutjeshëm, Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit në Lipjan dhe Organizata Jo-Qeveritare GERMIN - rruga "Tringë Smajli" Nr. 48, 10000, Prishtinë, përfaqësuar nga znj. Sihana Bejtullahu, në tekstin e mëtutjeshëm, Drejtoreshë e Programeve, më poshtë të referuara si "Palët", me vullnetin e lirë, pajtohen që në bashkëpunim të realizojnë programin "Lidhja e Profesionistëve të Diasporës për një Kosovë që duam";

Duke konsideruar interesin e dyanshëm, së bashku të zhvillojmë një modul interaktiv për diskutime dhe leksione, që synojnë të fuqizojnë gjeneratat e reja nga Komuna e Lipjanit;

Palët dëshirojnë që nëpërmjet një bashkëpunimi të tillë të ndihmojnë në realizimin e përgjegjësive të tyre dhe të inspirojnë dhe fuqizojnë nxënësitë e shkollave të mesme, duke i lidhur ata me profesionistë nga Diaspora.



Prandaj, palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

Palët në marrëveshje pajtohen për një bashkëpunim në realizimin e objektivave kryesore të programit, të cilat janë:

1. Angazhimi i ekspertëve të Diasporës për të mbështetur zhvillimin e sektorit të arsimit përmes transferimit të njohurive dhe aftësive;
2. Zhvillimi i një moduli interaktiv për diskutime dhe leksione, që synojnë të fuqizojnë gjeneratat e reja të liderëve të rinj në Kosovë (moduli do të zgjasë maksimumi 3 orë);
3. Përgatitja e gjeneratës së ardhshme të shkollave të mesme në zhvillimin e karrierës së tyre, duke maksimizuar potencialin e tyre përmes aplikimit të metodave për edukim jo-formal (si për shembull diskutime publike, ligjerata, etj). Në këtë mënyrë do të kuptojnë aftësitë që posedojnë, boshllëqet dhe mundësitë për zhvillim;
4. Zhvillimi dhe forcimi i aftësivë të komunikimit, duke përfshirë fjalimet publike, aftësitë për prezantim dhe komunikim, të nevojshme për tregun e punës dhe rëndësinë në rritje të komunikimit dhe
5. Fuqizimi i nxënësve të shkollave të mesme duke ua rritur vetëbesimin dhe aftësitë e tyre të buta për t'u bërë liderë të ardhshëm të Kosovës.

Kurse, aktivitet kryesore të këtij programi janë:

1. Angazhimi i profesionistëve të kualifikuar të diasporës për të ndarë njohuritë e tyre dhe transferimin e aftësive përmes prezantimeve, punëtorive, bisedave dhe seminareve të dizajnimit të menduarit tek nxënësit të moshës 15-18 vjeçare, në shkollën e përzgjedhur në Komunën e Lipjanit;
2. Organizimi i një takimi jo-formal me nxënësit, i cili do të jetë aktivitet jashtë kurrikular duke ofruar një qasje të edukimit bashkëkohor dhe cilësor;
3. Shkrimi i një editoriali/tregimi rreth ngjarjes së organizuar, duke promovuar programin, shkollën dhe nxënësit;
4. Realizimi i një dokumentari, i cili do të përcjell rrugëtimin e këtij moduli interaktiv në 10 komunitat e Kosovës;



Neni 2

Përgjegjësitë e palëve

1. Palët në marrëveshje, pajtohen që të përmbushin përgjegjësitë e tyre përkatëse në pajtim me disapozitat e këtij memorandumi.
2. Të mbajnë dhe ruajnë bashkëpunimin i cili respekton pavarësinë profesionale dhe transparencën e veprimeve konform kësaj marrëveshje.

Neni 3

Buxheti dhe Obligimet e Palëve

1. Obligimet dhe përgjegjësitë specifike për Komunën e Lipjanit:
 - a. Drejtoria e Arsimit në Komunën e Lipjanit do ndihmojë ekipin e GERMIN në përzgjedhjen e shkollës përmes mbajtjen e aktivitetit, bazuar në temen e cila do të përzgjidhet;
 - b. Drejtoria e Arsimit në Komunën e Lipjanit do ofrojë hapësirat dhe kapacitetet e saj për shfrytëzimin e shkollës së përzgjedhur në realizimin e aktiviteteve;
 - c. Ndihmon në promovimin e projektit në rrjetet sociale dhe rrjetin e tyre me ndikim ne përgjithësi.
2. Obligimet dhe përgjegjësitë specifike për Organizatën Germin:
 - a. GERMIN është përgjegjëse në mbulimin e këtyre kostove: Materialet e nevojshme për prezantim, ushqimin dhe pijet.
 - b. Organizon dhe realizon, në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit, respektivisht Drejtorinë e Arsimit të gjitha aktivitetet e Projektit të përshkruara në Nenin 1 dhe është bartëse e të gjitha procedurave për implementimin e këtij projekti;
 - c. Përdor të gjitha kapacitetet dhe resurset e saj në shërbim të arritjes së objektivave të Projektit;



Neni 4

Koordinimi

Palët koordinohen dhe komunikojnë mes vete përmes personave kontaktues:

Komuna e Lipjanit, Drejtoria e Arsimit: Personi kontaktues nga Komuna Lipjanit, respektivisht Drejtoria e Arsimit do të jetë: TEUTA BEKISHA.

Germin: Personi kontaktues nga OJQ Germin do të jetë: Arbnor Mjeku, Koordinator projekti.

Neni 5

Ndërprerja

Secila palë ka të drejtë të shkëputet nga kjo marrëveshje pas konsultimit paraprak të përbashkët dhe njoftimit paraprak me shkrim në afat prej të paktën gjashtëdhjetë (30) ditësh.

Neni 6

Kohëzgjatja

Ky program fillon më (1 Dhjetor 2019) dhe përfundon më (30 Mars 2020).

Neni 7


Validiteti

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët.



DREJTORIA E ARSIMIT

Znj. Elmaze Behluli, Drejtoreshë i Arsimit



Më 05.02.2020, vendi Lipjan



OJQ GERMIN

Znj. Sihana Bejtullahu, Drejtoreshë e
Programeve



Më 05.02.10, vendi Lipjan